



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 250/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Mitrovicë, për shkak të thyerjes së heshtjes parazgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Prishtinë.

Arsyetim

Me datën 08.06.2014, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se aktivistët e PDK-së kanë vërejtur se në qytetin Mitrovicës, në fshatin Koshtovë, konkretisht afër vendvotimit Nr. 1122/B rreth orës 11:30, zyrtari i degës së LDK-së në Koshtovë, Behram Hasani dhe disa aktivist të tjerë kanë penguar votuesit gjatë votimit dhe kanë shpërndarë material propagandistik. Lidhur me këtë rast kanë ndërhyrë edhe Policia e Kosovës. Parashtruesi i ankesës pretendon, se është shkelur neni 36 paragrafi 1 pika b) të Ligjit nr.03/L-073.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës me datën 08.06.2014, për ankesën që është bërë ndaj saj nga ana e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankesë deri më datë 09.06.2014 në ora 17:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ku konsiderojnë se është e pabazuar nga fakti se fotot e bashkangjitura si provë nuk vërtetojnë kurrfarë ndërlidhshmërie me shkeljen e supozuar në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet e parashtruesit të ankesës nuk qëndrojnë, sepse nga provat e ofruara në ankesë nuk mund të vërtetohet se ku ka qenë i vendosur materiali propagandues dhe është i pamundur identifikimi i personit në fjalë, ashtu siç pretendohet në ankesë. Me këtë rast PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova dhe në dëshmi bindëse, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 250/2014 më datën 09.06.2014



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*